



Ndërtesa e Kryeministrit - Tiranë

Cilat janë institucionet e përfshira në këtë proces?

- Kryeministria
- Aparatet e ministrive të linjës
- Institucionet në varësi të Kryeministrit dhe ministrive të linjës

Universitetet publike e private - duke kontribuar nëpërmjet përfaqësimit me staf akademik/pedagogë të fushave të ndryshme, si pjesë përbërëse e Komiteteve të Përhershme të vlerësimit të kandidatëve që deshirojnë të bëhen pjesë e shërbimit civil.

Roli i Departamentit të Administratës Publike

- Departamenti i Administratës Publike, nën përgjegjësinë e Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike është institucioni i cili udhëheq reformën në administratën publike me fokus mbi burimet njerëzore, ndërtimin e institucioneve dhe zhvillimit të politikave të pagës. Në kuadër të rritjes së kapaciteteve, DAP punon për rekrutimin e nëpunësve civil të aftë nëpërmjet organizimit të procedurave të rekrutimit.
- Misioni i Departamentit të Administratës Publike është sigurimi i një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike.

Kush jemi ne?

Qeveria shqiptare është e angazhuar fort për ta reformuar sektorin publik, kryesisht nëpërmjet masave që synojnë përmirësimin dhe konsolidimin e shërbimit civil për të krijuar një trupë profesionale dhe politikisht neutrale të nëpunësve civilë.

Si?

- Duke rekrutuar në shërbimin civil staf të përgatitur dhe të motivuar;
- Duke rritur kënaqësinë e punonjësve në shërbimin civil;
- Duke zhvilluar dhe ruajtur një mjedis pune cilësor;
- Duke stimuluar përfshirjen e ndryshimeve që sjellin përfitime për individët, grupet, institucionet dhe qytetarët.

Na kontaktoni për më shumë informacion

Telefon: **+355 4 2250488**

E-mail: kontakt@dap.gov.al

Web: www.dap.gov.al/

Facebook: Departamenti i Administratës Publike - DAP



Bashkimi Evropian



A jeni?

- I motivuar dhe i kualifikuar;
- Fleksibël dhe në gjendje të prioritarizoni;
- I aftë në përdorimin e kompjuterit;
- I rrjedhshëm në anglisht dhe gjuhë të tjera të huaja.

A keni ju?

- Aftësi të forta organizative;
- Një sjellje të përgjegjshme dhe angazhim ndaj punës dhe detyrimeve tuaja profesionale;
- Aftësinë për të punuar në grup.

A dëshironi?

- Të rrisni besimin e shoqërisë civile ndaj administratës publike;
- Të kontribuoni në rrugën e vendit drejt anëtarësimit në BE;
- Të keni një eksperiencë profesionale të pasuruar dhe stimuluese brenda shërbimit civil.



Kush është konteksti?

Shqipëria është angazhuar që prej vitit 2009, në një rrugë për t'iu bashkuar Bashkimit Evropian si një vend anëtar. Gjatë këtij viti u nënshkrua Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) ndërmjet Qeverisë shqiptare dhe Komisionit Evropian e cila do të përcaktonte udhërrëfyesin për tu ndjekur nga Shqipëria për tu bërë anëtare e plotë e BE-së.

Ky udhërrëfyes përfshin një sërë objektivash të qarta reformuese në sektorë të ndryshëm kyç që do ta sjellin Shqipërinë më afër me standardet e jetesës së BE-së për qytetarët e saj.

Reformimi i administratës është një komponent kryesor i procesit të përgjithshëm të reformës, ndërsa modernizimi i politikave të burimeve njerëzore në administratën publike përfaqëson një synim të rëndësishëm të nënvijëzuar dhe të planifikuar nëpërmjet dokumenteve strategjike si **Strategjia Ndër-sektoriale e Reformës në Administratën Publike 2015 – 2020** dhe **Plani Kombëtar për Integrimin Evropian për 2014-2020**.

Ky është shansi juaj për tu përfshirë!

E vetmja mënyrë për të realizuar këtë reformë është të tërheqim në shërbimin civil punonjës të përgatitur dhe të kualifikuar, dhe të krijojmë një drejtim karriere stimulues për ta. Qeveria po punon në mënyrë intensive për të krijuar një kuadër për performancën e punonjësve në sektorin publik.

„Kjo është mundësia juaj për të marrë pjesë në këtë ndryshim të madh të shoqërisë shqiptare.“

Si?

Duke përdorur njohuritë dhe aftësitë tuaja në shërbim të administratës publike shqiptare, duke hyrë në shërbimin civil, në fusha të ndryshme profesionale dhe duke punuar për ministri të ndryshme.

Çfarë ju pret?

- Mundësia për të kontribuar aktivisht në anëtarësimin e vendit tuaj në BE;
- Një shans për të mbështetur reformën e sistemit publik në Shqipëri dhe për ta rivendosur atë në një **bazë efektive, qasje të orientuar drejt performancës**;
- Të zhvilloni aftësitë tuaja dhe profilin profesional duke pasur akses ekspertizën dhe mjetet trajnuese të disponueshme në administratën shqiptare.



Puna në grup

Çfarë ofrojmë ne?

- Një mjedis pune të qëndrueshëm me një sistem të qartë të ngritjes në detyrë dhe zhvillimit të karrierës;
- Një sistem të mirë-strukturuar dhe modern të zhvillimit profesional për punëmarrësit, mbështetur nga institucionet publike dhe private arsimore (Shkolla Shqiptare e Administratës Publike ...);
- Akses të drejtpërdrejtë në procesin e reformës së administratës publike;
- Një plan stimulues shpërblyesi, performancë shpërblyese dhe përfshirje në proceset reformuese që zhvillohen.